



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr. 92, datë 27.11.2018

PËR

“DISA SHTESA NË DOKUMENTIN E TENDERIT PUBLIK ME PROCEDURË TË HAPUR ME OBJEKT: “DHËNIA E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN E FREKUENCAVE 800 MHZ (792-862 MHZ)”, REF. 1X10 MHZ I ÇIFTUAR-800-2018”, MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT DREJTUES NR. 47, DATË 5.7.2018”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 27.11.2018, konform procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, si dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Disa shtesa në dokumentin e tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 Mhz (792-862 mhz)”, ref. 1x10 Mhz i çiftuar-800-2018”, miratuar me vendim të Këshillit Drejtues Nr.47, datë 5.7.2018”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 68, 69, pika 1, neni 114 dhe pika 1, neni 115, të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në RSH”, i ndryshuar (**Ligji 9918/2008**);
2. Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**Ligji 44/2015**).

3. Pika 6.2, Kreu III i VKM-së Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, e ndryshuar;
4. Rregullore e brendshme e funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të KD të AKEP;
5. Urdhri Nr.404 i Kryetarit të KD-së së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike datë 28.06.2018 “Për zhvillimin e procedurës për konkurimin publik për dhënien të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”, i ndryshuar;
6. VKD nr.47, datë 05.07.2018 për “Miratimin e dokumentit të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 mhz (792-862 mhz)”, ref. 1x10 mhz i çiftuar-800-2018;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- a. Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- b. Relacion shpjegues;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

Në Kreun II “Procedura e tenderit dhe udhëzime për ofertuesit”, pika 11, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të dokumentave të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 mhz), ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018”, në nënpikën 11.4 përcakton se, “KVO, vlerëson se **oferta është e vlefshme, nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e tenderit dhe në dokumentin e tenderit**”, ndërkohë që në vëmendje të objektit të këtij tenderi publik, kemi të bëjmë me dhënien e disa të drejtave përdorimi në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 mhz), ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018.

Në këtë kontekst, konsiderohet i nevojshëm ndryshimi i pikës së lartpërmendur, duke saktësuar se secili prej operatorëve, mund të paraqesë oferta për tre të drejta përdorimi, dy, apo dhe vetëm një prej tyre, e rrjedhimisht skualifikimi për çdo njëren prej arsyeve të parashikuara në dokumentat e tenderit, nuk e përjashton ofertuesin të konkurrojë për të drejtat e përdorimit të mbetura.

Referuar pikës 6.2 të Kreut III të VKM-së Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, e ndryshuar, parashikohet: “AKEP, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave të tenderit dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një kandidat, mund të bëjë ndryshime në dokumentin e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë kandidatëve blerës, që kanë tërhequr dokumentin e tenderit, dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. Në çdo rast, AKEP e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 5 ditë”, AKEP, duke synuar shterrimin e çdo paqartësie që mbart përmbajtja e pikës së lartpërmendur, të Dokumentit të Tenderit me procedurë të hapur me

objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 mhz (792-862 mhz)”, ref. 1x10 mhz i çiftuar-800-2018”, konsideron se:

nënpika 11.4, “KVO, vlerëson se oferta është e vlefshme, nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e tenderit dhe në dokumentin e tenderit”,

duhet të ndryshojë si më poshtë,

“KVO, vlerëson se ofertat janë të vlefshme për një, dy apo të tre të drejtat e përdorimit, nëse ato janë në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e tenderit dhe në dokumentin e tenderit”.

Në vëmendje të ndryshimit të lartpërmendur në dokumentet e tenderit, AKEP, referuar përcaktimit ligjor të shprehur në pikën 6.2 të të Kreut III të VKM-së Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, e ndryshuar, zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertave, nga operatorët e interesuar, **në datën 07.02.2019, ora 10:00.**

Vlen të theksohet se shtesat dhe ndryshimet në Kreun II, “Procedura e tenderit dhe udhëzime për ofertuesit”, pika 11, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, nënpika 11.4 të dokumentave të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 mhz), ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018”, duke shtyrë gjithashtu afatin e zhvillimit të tenderit sipas parashikimeve ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi, reflektojnë edhe paqartësitë e shprehura lidhur me këtë pikë të dokumenteve të tenderit, nga operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Gjithashtu, shtyrja e procedurës së tenderit publik si rrjedhojë e ndryshimeve në dokumentat e tenderit, përmbush dhe kërkesën për shtyrje të paraqitur nga sipërmarrësi “Telekom Albania” sh.a, me Nr.Prot.7115, datë 26.11.2018 (administruar në AKEP me Nr.688/31,prot, datë 26.11.2018) me arsyetimin se ndodhet në procesin e shitjes së aksioneve, çfarë dhe vendos AKEP në pozitë të krijuar të një klime mbështetëse për biznesin dhe investimeve të qëndrueshme në fushën komplekse dhe me dinamike të lartë zhvillimi, sikurse është fusha e Komunikimeve Elektronike.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe pikës 6.2 të Kreut III të VKM-së Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet në nënpikën 11.4, Kreu II “Procedura e tenderit dhe udhëzime për ofertuesit”, pika 11, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të dokumentave të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të

drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 mhz), ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018”.

2. Të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertës në datën 07.02.2019, ora 10:00, dhe ky afat i ndryshuar të reflektohet në të gjithë dokumentin e tenderit publik.
3. Ngarkohet njësia e hartimit të dokumenteve të ndjekë procedurën për sa parashikohet në këtë vendim.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar
Ilir ZELA

Anëtar
Edlira DVORANI

Anëtar
Klarina ALLUSHI

Anëtar
Ketrin TOPÇIU